



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 19

NR. VENDIMI 100

V E N D I M
“ NE EMER TE REPUBLIKES “

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga,

HOXHA	GJYQTAR	GERD
ÇOMO	GJYQTAR	PETRIT
KRASNIQI	GJYQTAR	BUJAR

asistuar prej sekretares gjyqesore **Elenita Zoto**, sot me date **31 janar 2012**, me kerkesen e **Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane**, perfaqesuar nga prokurori **Z.Albert Demirneli**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike, çeshtjen penale nr.19akti, ne ngarkim te

Te pandehurit:
Nanterre

Bruno Hamard, dtl.07.04.1970, shtetas francez, lindur ne

La Chapelle Saint

France dhe banues ne adresen : 39 Rye Bel Air 45380

hetuar ne gjendje te

Mesmin, France, gjendja gjyqesore e paverifikuar,

Celibashi.

lire, ne mungese, i mbrojtur kryesisht nga *Av.Aurel*

Akuzuar :
personave”,

Per vepren penale te **“*Mashtrimit ne dem te disa***

parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal.

Ne perfundim te hetimit gjyqesor Gjykata, pasi administroi provat shkresore dhe degjoi deshmitaret; degjoi prokurorin, i cili kerkoi :

- deklarimin fajtor te te pandehurit Bruno Hamard, per kryerjen e vepres penale te **“*Mashtrimit ne dem te disa personave*”,** parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal dhe bazuar ne kete nen, denimin e tij **me 5 (pese) vjet burgim**;
- detyrimin e te pandehurit te paguaje shpenzimet procedurale;

degjoi mbrojtetin e te pandehurit, qe kerkoi deklarimin e pafajshem te te pandehurit Bruno Hamard per kryerjen e vepres penale te **“*Mashtrimit ne dem te disa personave*”,** parashikuar nga neni 143/2 i KP; si dhe pasi e shqyrtoi çeshtjen ne teresi

V E R E N

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane eshte sjelle per gjykim çeshtja penale ne ngarkim te te pandehurit Bruno Hamard, akuzuar per vepren penale te **“*Mashtrimit ne dem te disa personave*”,** te parashikuara perkatesisht nga neni 143/2 i K.Penal.

Nga administrimi qe i'u bene akteve shkresore te ndodhura ne dosje si dhe nga pyetja e deshmitareve rezultoi i provuar fakti se, i pandehuri Bruno Hamard ka konsumuar plotesisht me dashje, vepren penale te "Mashtrimit ne dem te disa personave", parashikuar nga pg.II i nenit 143 te K.Penal.

Me konkretisht, gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi se, ne Shqiperi ka zhvilluar aktivitet te paligjshem i ashtuquajture institut francez "IRERIE", i cili ofronte programe studimi pasuniversitare per fitimin e diplomave "Master". Nga hetimi ka rezultuar se, ky Institut, drejtohej nga shtetasi frances Bruno hamard ndersa, "dega"e ketij Instituti ne Tirane drejtohej nga deshmitari Andrea Nathanaili. Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi se **IRERIE** ka leshuar nje numer te konsiderushem diplomash, per shtetas te ndryshem shqiptare, kundrejt pageses. Rezulton se, **IRERIE** nuk eshte i rregjistruar ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences te RSH. **IRERIE** ka patur faqen e tij ne internet te quajtur www.irerie.eu. Kjo adrese jepte informacion sipas te cilit **IRERIE** eshte nje institut ne fushen e kerkimeve dhe studimeve te larta pasuniversitare (*Master dhe Doktorature*).

I pandehuri Bruno Hamard eshte shtetas francez. Ne vitin 1995, ne France ai eshte njohur me shtetasin shqiptar, deshmitarin Petrit Nathanaili, i cili kishte shkuar kohe me pare ne France per studime pasuniversitare. I pandehuri Bruno Hamard duke shfrytezuar kete njoheje, ne vitin 2003 ka kontaktuar me deshmitarin Petrit Nathanaili, i cili ne ate kohe ka patur graden "Profesor" ne lenden e Historise se Mardhenieve Nderkombetare ne Fakultetin e Histori – Filologjise Tirane. Gjate komunikimit telefonik dhe bisedave te zhvilluara ne takimet mes tyre i pandehuri Bruno Hamard ka hedhur idene e krijimit te nje dege studimi me studente "Frankofone", per studime te thelluara "Master" dhe "Doktorature" ne fushen e Marredhenieve Nderkombetare. Ne funksion ne qellimit te tij, i pandehuri fillimisht ka mundur qe, me ane te mirebesimit te bind shtetasin Petrit Nathanaili, duke i thene atij se nje dege e tille ishte hapur prej te pandehurit ne Hunagari dhe se i pandehuri kishte krijuar per kete qellim edhe institutin "**IRERIE**", te cilen e drejtonte ai vete. Ky institut, sipas te pandehurit Bruno Hamard, ishte funksional dhe se kishte stundente nga shtete si Rumania, Hungaria, Turqia, Franca etj... I pandehuri Bruno Hamard i ka thene deshmitarit Petrit Nathanaili se Instituti "**IRERIE**" eshte i licensuar dhe i njohur nga Autoritetet Franceze. Sipas prokurorise, i pandehuri e ka siguruar deshmitarin Petrit Nathanaili se, nje veprim te tille do ta bente edhe per njohjen e diplomave ne shetin Shqiptar, qe ky Institut do te jepte per studentet shqiptare. Pasi deshmitari Petrit Nathanaili eshte bindur se i pandehuri Bruno Hamard ishte nje njeri serioz dhe se Institutu "**IRERIE**" qe ai drejtonte ishte i njohur ligjerisht, ka pranuar qe te bashkepusoje me te. Ne keto kushte i pandehuri Bronu Hamard i ka kerkuar deshmitarit Petrit Nathanaili qe te perzgjidhte edhe stafin akademik, te cilet do te jepnin leksionet ne cileklin e programit mesimor "on-line" per deget "Master" dhe "Doktorature" ne fushen e Marrdhenieve Nderkombetare.

Ne kuader te pregatitjeve per fillimin e ketije aktiviteti i pandehuri ka sjelle edhe programet mesimore dhe flet – palosjet ku pershkruhej aktiviteti dhe adresa e Institutit. Sipas ketyre materiale, te cilat jane administruar gjate ketij procesi penal, ky Institut i Kerkimeve Nderkombetare dhe Europiane kishte krijuar kurse pasuniversitare per studime te larta "Master" dhe "Doktorature" ne kete fushe. Ne keto kushte i pandehuri ka sjelle ne Shqipri programet mesimore te cilat nuk ishin te miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences. Gjithahstu, nga gjykimi rezultoi se, aktiviteti i ketije Instituti nuk ishte licensuar dhe ne vitin 2003. I pandehuri ka krijuar vete formen e modulit, seksioni Shqiptare i Institutit "**IREIRE**" me drejtor, Profesor Petrit Nathanailin. Programet "Master" do te kryheshin on-line, te cilat u dergoheshin me email studenteve. Keta te fundit pergjigjet e pyetjeve do ti dergonin po ne rruge elektronike online dhe pergjigjet e rezultateve te pyetjeve merreshin ne te njeten rruge.

Fillimisht aktiviteti i ketij Instituti me qender ne Tirane - Fakulteti i Historise dhe

Filologjise me Drejtor per Shqiprine deshmitarin Petrit Nathanaili ka patur 17 (shtatembedhjet) studente. Duke qene se ishte viti i pare i aktivitetit i pandehuri ka vendosur qe cmimi per studime per nje student fillimishte te jete 300 euro. Studentet qe jane regjistruar kane paguar kundrejt nje mandat pagese tek shtetasi Petrit Nathanaili shumen prej 300 euro. E gjitha shuma qe paguhej nga studentet per keto studime i kalohej Institutit “**IREIRE**” ne llogarine e te pandehurit ose vete i pandehuri kur, ky i fundit vinte ne Tirane dhe i terhiqte ato nga tek shtetasi Petrit Nathanaili. Nje pjese e kesaj pagese perdorej per te paguar lektoret, qe jepnin mesim ndersa, gjithë pjesa tjeter e parave kalonte ne favor te pandehurit Bruno Hamard. Ne vitin e dyte te studimit, qe perkon me vitin 2004 numri i studenteve erdhi ne rritje kjo edhe per shkak te publicitetit te madh, qe i pandehuri i bente Institutit “**IREIRE**” ne Tirane, sa here qe ai vinte ne Tirane. Kete publicitet i pandehuri e bente duke shfrytezuar mesemiri çdo takim, qe ai bente me zyrtare te larte qendrore dhe lokale. Duke qene se numuri i studenteve filloi te rritej, i pandehuri, menjehere e shfrytezoi kete mundesi dhe e rriti kuoten e pranimit te tyre ne kete Institut nga 300 euro, ne 1000 mije euro per cdo student. Ne vitin akademik 2006 – 2007 kane vijuar studimet ne kete Institut 65 studente.

Me qellim qe stafi pedagogjik dhe studentet te kishin besim tek ai dhe instituti qe ai drejtonte, i pandehuri Bruno Hamard ka ardhur vete ne Shqipri disa here, duke organizuar edhe aktivite te ndryshme qofte ne Ministrine e Mbrojtjes ashtu edhe ne Prefekturen e Rrethit Durres. Ai gjithashtu ka marre pjese vete ne ceremonite e diplomimit te disa grupe studentesh dhe ka organizuar vete ceremonite e shperndarjes se diplomave, duke ftuar me kete rast edhe personalitetet te fushave te ndryshme dhe zyrtare te larte te Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Ministrise se Integritimit, etj..., me qellim qe te largonte çdo dyshim ne lidhje me aktivitetin e paligjeshem, qe Instituti i **IREIRE** kryente ne Republiken e Shqiprise.

Gjate gjykimit rezultoi se, i pandehuri Bruno Hamard eshte paraqitur para autoriteteve Shqiptare si perfaqesues i urdhetrit “*Saint quent & de L’Etoile*”. Nen kete paraqitje, i pandehuri ka kryer takime me perfaqesues te larte te Administrates shterore, duke u prezantuar me imunitet diplomatik si dhe ka nenshkruar marrveshje me Dhomen e Tregtise dhe Prefekturen e Qarkut Durres, ne fushen e bashkepunimit ekonomik dhe biznesit. Perdorimi dhe paraqitja e te pandehurit si perfaqesuse i ketije urdheri eshte bere per te krijuar lehtesira ne aktivitetin e tij kriminal. Gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi e provuar plotesisht se, provave shkresore te ardhura nga Ambasada Franceze e Akredituar ne Tirane, Instituti “**IRREIRE**” eshte i panjohur ne mjediset akademike Franceze. Per rrjedhoje diplomat qe shperndan ky Institut nuk kane asnje forme njohje ose ekuivalence ne shtetin Francez. Gjithashtu urdheri “*Saint quent & de L’Etoile*”, ku mbeshtetet ky Institut nuk eshte i njohur ne shtetin Francez.

Faktet e deshmuara me sipër, u interpretuan nga mbrojtësi i te pandehurit si veprimtari e ligjshme e te pandehurit. I pandehuri pretendoi se, ai u ofronte nje sherbim ketyre shtetasve, duke i ndihmuar per te marre nje diplome pas kryerjes se nje peridudhe studimi serioze dhe dhenies se provimeve. Kete sherbim i pandehuri e kryente kundrejt nje shpreblimi.

Pasi u degjuan deshmitaret Petrit Nathanaili, Zyrada Kongoli, Andrea Xhavarra, Eva Tafili (Hyskaj), Lirjana Demiraj, Zana Dyrmishi dhe u administruan provat shkresore ne diskutimin perfundimtar prokurori kerkoi deklarimin fajtor dhe denimin me 5 (pese) vjet burgim te te pandehurit Bruno Hamard per kryerjen e vepres penale te “*Mashtrimit ne dem te disa personave*”, te parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal.

Faktet e mesiperme u vertetuan nga administrimi i provave si vijon: shkresa nr.7634 prot, dt.15.10.2007 e Ministrise se Arsimit dhe Shkences; shkrese nr.11769 prot, dt.07.09.2007 e Ministrise se Puneve te Jshtme; shkrese nr.954 prot, dt.20.08.2007 e Ambasades Franceze ne Tirane, drejtuar Ministrise se Arsimit dhe Shkences; shkrese nr.953 prot, dt.20.08.2007 e Ambasedes Franceze ne Tirane, drejtuar Ministrise se Brendeshme te

Republikes se Shqiperise; kopje e diplomave “*Master*” te leshuara nga Instituti “*IREIRE*”; marrveshje e urdherit ”*Saint quent & de L’Etoile*“ dhe Prefektures se Qarkut Durrës; akte te ardhura nga autoritete gjyqesore Franceze ne pergjigje te leterporosise per ndihme gjyqesore ne fushen penale, me nr.reference 124 CR 09 date 19 Qershor 2009; akti i ekspertimit teknik date 30.06.2008 i kryer nga eksperti kontabel Sami Kapxhiu; deshmite e shtetasve Petrit Nathanaili, Zyrada Kongoli, Andrea Xhavarra, Eva Tafili (Hyskaj), Lirjana Demiraj, Zana Dyrmishi, si dhe i gjithe materiali shkresor i ndodhur ne fashikullin e hetimit nr.4407, te administruar si prova nga Gjykata.

Persa i perket kualifikimit ligjor te fakteve te vertetuara sa me siper Gjykata veren se, neni 143 i K.Penal parashikon : “*Vjedhja e pasurise me ane te genjeshtrës ose shperdorimit te besimit denohet me gjobe ose me burgim gjer ne pese vjet. Po kjo veper, kur kryhet ne bashkepunim, ne dem te disa personave ose me shume se nje here denohet me burgim nga tre gjer ne dhjete vjete vjet dhe kur ka sjelle pasoja te renda, me burgim nga dhjete gjer ne njezete vjet.*”

Nga interpretimi i dispozites se mesiperme rezulton se, ligjvenesit ka parashikuar nje mbrojtje te posaçme juridike te marredhenieve qe garantojne sigurine dhe paprekshmerine e pronës private dhe asaj shteterore, nga veprime ose mosveprime te kundraligjshme e shoqerisht te rrezikshme, qe synojne pakesimin e kesaj pasurie. Sipas kesaj dispozite, veprimet qe cenojne marredheniet e siperpermendura passjellin pergjegjesi penale. Keto veprime, per t’u cilesuar si veper penale nga ligji, duhet qe :

- objekt i vepres penale te jete konkret dhe i vleresueshem;
- nga ana objektive i pandehuri me veprime aktive, te kundraligjshme te kete hedhur ne dore ne menyre te fshehte ose te hapur pasurine e nje personi tjetër-te demtuarit, me ane te genjeshtrës dhe/ose shperdorimit te besimit te ketij te fundit, duke pakesuar ne kete menyre pasurine e te demtuarit. Nese mashtrimi kryhet ne dem te disa personave, me shume se nje here ose ne bashkepunim, apo ka sjelle pasoja te renda, vepra penale do te cilesohet sipas paragrafit II te nenit 143 dhe denimi do te jete me i rende ;
- subjekti i vepres penale te kete mbushur moshen per pergjegjesi penale, ne rastin konkret te kete mbushur 14 vjeç si dhe te jete i pergjegjshem;
- hedhja ne dore e pasurise se tjetrit nga i pandehuri duhet te behet me qellim per mos t’ju kthyer me pronarit,

Ne rastin konkret, siç rezultoi e provuar nga shqyrtimi gjyqesor, te pandehurit Bruno Hamard, me qellim sigurimin e te ardhurave, i ka lindur mendimi kriminal qe t’i siguronte keto te ardhura per vete dhe familjen e e tij ne rruge te kunderligjshme, duke mashtruar persona te ndryshem, sikur ishte ne gjendje ti pajiste me diploma “*Master*” apo “*Doktorature*”, ne fushen e marredhenieve nderkombetare. Per kete qellim, ai ka krijuar edhe Institutin “*IREIRE*”, per te mundesuar studimet per “*Master*” dhe “*Doktorature*”. Ne vitin 1995, ne France i pandehuri eshte njohur me shtetasin shqiptar, deshmitarin Petrit Nathanaili, i cili kishte shkuar kohe me pare ne France per studime pasuniversitare. I pandehuri Bruno Hamard duke shfrytezuar kete njoheje, ne vitin 2003 ka kontaktuar me deshmitarin Petrit Nathanaili, i cili ne ate kohe ka patur graden “*Profesor*” ne lenden e Historise se Marredhenieve Nderkombetare ne Fakultetin e Histori – Filologjise Tirane. Gjate komunikimit telefonik dhe bisedave te zhvilluara ne takimet mes tyre i pandehuri Bruno Hamard ka hedhur idene e krijimit te nje dege studimi me studente “*Frankofone*”, per studime te thelluara “*Master*” dhe “*Doktorature*” ne fushen e Marredhenieve Nderkombetare. Ne fuksion ne qellimit te tij kriminal, i pandehuri fillimisht ka mundur qe, me ane te mirebesimit te bind shtetasin Petrit Nathanaili, duke i thene atij se nje dege e tille ishte hapur prej te pandehurit ne Hunagari dhe se i pandehuri kishte krijuar per kete qellim edhe institutin “*IRERIE*”, te cilen e drejtonte ai vete. Ky institut, sipas te pandehurit Bruno Hamard, ishte funksional dhe se kishte studente nga shtete si Rumania, Hungaria, Turqia, Franca etj... I

pandehuri Bruno Hamard i ka thene deshmitarit Petrit Nathanaili se Instituti “**IRERIE**” eshte i licensuar dhe i njohur nga Autoritetet Franceze. Pasi deshmitari Petrit Nathanaili eshte bindur se i pandehuri Bruno Hamard ishte nje njeri serioz dhe se Instituti “**IRERIE**”, qe ai drejtonte ishte i njohur ligjerisht, ka pranuar qe te bashkepusoje me te. Ne keto kushte i pandehuri Bruno Hamard i ka kerkuar deshmitarit Petrit Nathanaili qe te perzgjidhte edhe stafin akademik, te cilet do te jepnin leksionet ne cileklin e programit mesimor “on-line” per degjet “*Master*” dhe “*Doktorature*” ne fushen e Marredhenieve Nderkombetare. Nderkohe, qe i pandehuri ka pregatitur dhe sjelle ne Tirane “*programet e nevojshme dhe kurrikulat*” per te studiur ne kete Institut.

Nisur nga sa me siper Gjykata arrin ne perfundimin se, aktiviteti i Institutit “**IRERIE**”, i themeluar dhe drejtuar nga i pandehuri Bruno Hamard ka qene i paligjshem. Ky institut eshte krijuar dhe drejtuar nga i pandehuri me qellim e vetem te pervetesimin me ane te shperdorimit te besimit dhe genjeshtrës te shumave te parave, qe studentet shqiptare kane arketuar ne kete institut. Ky Institut nuk ka qene asnjehere i licensuar dhe i regjistruar prane Ministrise se Arsimit dhe Sheknces se Shtetit Shqiptar. Per rrjedhoje diplomat qe ky Institut leshonte nuk kishin asnje vlere, pasi ato nuk njihen nga autoritet shterore te Shtetit Shqiptar. Fakti se, ky Institut nuk kane qene i regjistruar dhe i licensuar prane Ministrise se Arsimit dhe Sheknces provohet edhe me shkresen nr.7634 prot date 15.10.2007, te kesaj Ministrie, ku nder te tjera thuhet se “*Ky institucion asnjehere nuk eshte paraqitur per t’u licensuar dhe aq me pak per te kerkuar akreditimin nga anutoritetet shqiptare. Ato pretendojne se jane Institucion Franceze i ligjshem, por Autoritetet Franceze e mohjone kete ne menyre kategorike*”.

Instituti “**IRERIE**” i krijuar nga i pandehuri Bruno Hamard ishte nje Institut i jashteligjeshem dhe sherbente si mjet qe, ky i pandehur te perfitonte nepermjet mashtrimit. Nje fakt te tille e provojne edhe dokumentete e ardhura nga Shteti Francez ne pergjigje te leterporosese per ndihme juridike ne fushen penale te ardhur nga Paris, me date 19 Qershor 2009 me nr. reference 124 CR 09 ku nder te tjera theksohet se: “*Statuset e OSOE, kishin si qellim te vinin ne ndihme disa femijve jetim dhe adulteve invalide. Ne te vertete presidenti i saj Bruno Hamard kishte mashtruar urdherin e Maltes per te nxjerr ne drite nje urdher te vjeter kalorsie, duke pretenduar keshtu per nje shtet te pamvarur, per te justifikuar cilesine e diplomateve per aderentet e veta. Nese OSOE numeron pak aderente ne France ajo ka shume antare ne Europe dhe Afrike. I pandehuri Bruno Hamard dhe bashkeshortja e tij Cecile Hamard (Vrain) perkatesishte President dhe Sekeretare ishine vendosur me pare ne Hungari. Nen pretekstin e OSOE drejtuesit perpiqeshin mbi te gjitha te perfitonin finaciarisht nga njerez, te cilet u besonin atyre duke u shitur targa dhe pashaporta diplomatike ne vleren 500 euro, si dhe u kishin shitur dipllloma nepermjet institutit “**IRERIE**” me vleren 1000 euro. Kurset shperndaheshin ne internet sidomos nga Z.Oliver Buirette, qe ka gjetur nje burim jo te paket te ardhurashe mes 1000 – 2000 euro ne muaj. Instituti “**IRIERE**” nuk ekziston ne France dhe zgjedhja e kesaj sigle nuk eshte nje rastesi. Pasi ne France ekziston Instituti i Studimeve dhe Kerkimeve Nderkombetare te Parisit, diplommat e te cilit njihen dhe jane te njohura. Z.Olivier BUIRETTE konfirmonte se kishte qene drejtor i thesarit te shoqates OSOE dhe kishte dhene mesim ne Institutin e “**IRERIE**”. Ai pranon se Instituti nuk kishte asnje ekzistence te ligjshme dhe se diplomat e leshuara nuk kishin asnje vlere, duke shtuar se keto dy struktura prej te cilave ishte larguar kishin kryer veprime te paligjeshme nen drejtimin e presidentit te tyre te pandehurit Bruno Hamard”.*

Nga sa me siper Gjykata arrin ne perfundimin se, i pandehuri Bruno Hamard me dashje, duke perdorur genjeshtrën dhe duke shperdoruar besimin e disa dhjetra shtetasve shqiptare mes tyre deshmitaret e pyetur gjate gjykimit, ka arritur te hedhe ne dore prej tyre shuma parash qe variojne nga 300 deri ne 1 000 euro per person, duke u premtuar kryejen e

studimeve dhe me pas pajisjen me diploma “*Master*” dhe “*Doktorature*” ne fushen e marredheneieve nderkombetare, nga Instituti IREIRE, te njohura ligjerisht nga shteti shqptar dhe ne arenen nderkombetare.

Nisur nga sa me siper, gjykata arrin ne perfundimin se, i pandehuri Bruno Hamard u ka paraqitur deshmitareve te pyetur gjate gjykimit si dhe personave te tjere, qe kane frekuentuar degen e Institutit **IREIRE** ne Shqiperi rrethana te paverteta, te kunderta me realitetin, duke i genjyer keta te fundit e si rezultat i kesaj genjeshitre ka arritur te hedhe ne dore nga keta shtetas (*perveç shtetasit Petrit Nathanaili*), me qellim per te mos kthyer me, shumat ne euro te pershkruara me siper.

Gjithashtu gjate gjykimit rezultoi se, i pandehuri Bruno Hamard eshte menderisht i pergjegjshem e ka mbushur moshen (14 vjeç) per pergjegjesi penale, qe kerkon kjo veper.

Ne kete menyre, i pandehuri Bruno Hamard ka konsumuar plotesisht elementet e vepres penale te “*Mashtrimit ne dem te disa personave*”, parashikuara nga neni 143/2 i K.Penal. Sa me siper Gjykata, ne veshtrim te nenit 143/2 te K.Penal, e gjen fajtor te pandehurin Bruno Hamard per vepren penale te “*Mashtrimit ne dem te disa personave*”.

Persa i perket llojit dhe mases se denimit qe duhet te vuaje i pandehuri Bruno Hamard, si pasoje e kryerjes se vepres penale te “*Mashtrimit ne dem te disa personave*”, parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal Gjykata çmon se, duhen mbajtur parasysh keto rrethana :

1. Rrezikshmerine relativisht te larte te vepres penale, per te cilat ligjvenesit ka parashikuar nje denim nga tre gjer ne dhjete vjet burgim.
2. Faktin se, i pandehuri nuk eshte paraqitur perpara organeve te drejtesise. Madje nga pergjigjia e leterporosise se ardhur nga autoritetet franceze ka te dhena se, i pandehuri i fhsihet drejtesise.
3. Faktin se, i pandehuri ka vepruar me dashje direkte, duke hartuar dhe vene ne jete nje plan te miremenduar e te sofistikuuar kriminal ne vende te ndryshme dhe kohe relativisht te gjate (disa vjet).
4. Faktin se, i pandehuri ka shfrytezuar nevojën e deshmitareve per tu arsimuar, me qellim rritjen e cilesise se jeteses se tyre.
5. I pandehuri edhe sot e kesaj dite nuk e ka zevendesuar demin qe kane pesuar te demtuarit. Gjykata veren se, ky dem monetar eshte i vogel por, i larte eshte demi moral qe i eshte shkaktuar secilit prej « studenteve » te IREIRE.
6. Nuk rezulton se i pandehuri, nuk ka qene i denuar me pare.

Ne keto kushte Gjykata veren se, rrethanat e mesiperme, ne te cilat eshte kryer vepra penale, ne kompleksitet, jane renduese per te pandehurin Bruno Hamard dhe se, i pandehuri paraqet rrezikshmeri shoqerore relativisht te larte, e cila e ben te domosdoshem izolimin e tij nga shoqeria. Nisur nga sa me siper Gjykata çmon se, i pandehuri Bruno Hamard duhet te denohet me 5 (pese) vjet burgim, per kryerjen e vepres penale te « *Mashtrimit ne dem te disa personave* », parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal.

Ky denim, sipas Gjykates eshte plotesisht i justifikueshem, duke e krahasuar ate me rrezikshmerine shoqerore te vepres penale te «*Mashtrimit ne dem te disa personave*», rrethanave te kryerjes se saj dhe rrezikshmerine shoqerore te te pandehurit ne rastin konkret. Gjithashtu Gjykata çmon se, ky denim do t’i sherbeje edukimit te te pandehurit, parandalimit te kryerjes se veprave te tjera penale nga i pandehuri, si dhe parandalimit te pergjitheshem te kesaj veprave penale ne shoqeri.

Duke qene se, i pandehuri Bruno Hamard u shpall fajtor dhe u denua per vepren penale per te cilen akuzohet, ne baze te nenit 485 te K.Pr.Penale, i pandehuri duhet te paguaje shpenzimet proceduriale ne fazen e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqesore.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 379, 384, 390 e 485 te K.Pr.Penale,

V E N D O S I

1. Deklarimin fajtor te te pandehurit ***Bruno Hamard*** per kryerjen e vepres penale te “*Mashtrimit me shume se nje here*“, e parashikuar nga neni 143/2 i te K.Penal dhe denimin e tij **me 5 (pese) vjet burgim.**
2. Vuajtja e ketij denimi do te filloje nga dita e ekzekutimit te ketij vendimi. Denimi do te vuhet ne nje burg te sigurise se zakonshme.
3. Shpenzimet procedurale ne fazen e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqesore, i ngarkohen te pandehurit.
4. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim, brenda 10 (dhjete) diteve nga e nesermja e shpalljes se tij, ne Gjykatën e Apelit Tirane. Per te pandehurin ne mungese ky afat fillon nga dita e njoftimit te ketij vendimi.

U shpall ne Tirane, sot me dt.31 janar 2012!

SEKRETARE

GJYQTAR

Elenita

GERD HOXHA

ZOTO